

RAPORT STUDIMOR

INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA SHKODËR



INTELEKTUALËT E RINJ SHPRESË
QERSHOR 2022

Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE	3
2. LISTA E SHKURTIMEVE.....	5
3. PROFILI I BASHKISË SHKODËR.....	6
4. METODOLOGJIA	8
5. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK.....	9
6. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË SHKODËR.....	13
7. GJETJET NGA AKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E KËSHILLIT BASHKIAK.....	22
8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	30

1. HYRJE

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse ne Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjeteve dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të

marrë pjesë dhe për t'u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.

2. LISTA E SHKURTIMEVE

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

3. PROFILI I BASHKISË SHKODËR

Karakteristikat Gjeografike

Bashkia Shkodër shtrihet në veriperëndim të Shqipërisë në një territor prej 873 km², i cili kufizohet në veri me Bashkinë e Malësisë së Madhe, në perëndim me Malin e Zi, në lindje me Bashkinë Tropojë, në jug me Bashkinë Vau i Dejës dhe me Bashkinë Lezhë. Bashkia e Shkodrës përbëhet nga 93 fshatra dhe një qytet, Shkodra, e cila është edhe jo vetëm qendra e Bashkisë, por edhe kryeqendra e veriut të Shqipërisë.

Qyteti i Shkodrës ndodhet në veriperëndim të Shqipërisë. Në veriperëndim të tij ndodhet Liqeni i Shkodrës, i cili është liqeni më i madh në Ballkan. Nga ky liqen buron Lumi Buna, i cili derdhet në detin Adriatik dhe rrjedha e poshtme e të cilit ndan kufirin me Malin e Zi. Lumi Buna bashkohet me lumin Drin në jugperëndim të qytetit. Nga ana lindore qyteti kufizohet me Lumin Kir, i cili buron nga Malësitë e Veriut. Ky lum derdhet në Lumin Drin që rrethon Shkodrën nga ana jugore.

Qeverisja Vendore

Bashkia e Shkodrës është pjesë e Qarkut Shkodër dhe përbëhet nga 11 njësi të qeverisjes vendore, (Shkodër, Rrethina Shalë, Shosh Pult, Postribë, Guri i Zi, Ana e Malit, Bërdicë, Dajç, dhe Velipojë). Në përbërjen e tyre këto njësi administrative përfshijnë gjithsej një qytet dhe 93 fshatra. Qyteti Shkodër është njësi administrative qendër e Bashkisë. Organi përfaqësues i bashkisë është Këshilli Bashkiak Shkodër, i cili përbëhet nga 51 këshilltarë, përfaqësues të subjekteve të ndryshme politike të zgjedhur në zgjedhjet vendore.

Demografia

Me reformën e re territoriale, popullsia e Bashkisë së Shkodrës është dyfishuar. Aktualisht kjo bashki ka një popullsi prej 204,954 banorë. Përqëndrimi më i madh i popullsisë është në qytetin e Shkodrës me 55% të popullsisë (114,085 banorë), ndërsa për sa i përket njësive administrative, njësi me popullsi më të madhe është ajo e rrethinave me 23,923 banorë.

Njësitë e tjera më të mëdha nisur nga numri i popullsisë janë: Guri i Zi me 11,838 banorë, Postriba me 11,730 banorë, Bërdica me 9,655 banorë, Velipoja me 9,574 banorë dhe Dajçi me 8,998 banorë. Tre njësitë e tjera më të vogla për nga numri i popullsisë janë Ana e Malit me 5,968 banorë, Pulti me 3,249 banorë, si dhe Shalë e Shosh me 5,934 banorë.

Profili Ekonomik

E pozicionuar në qendër të ndërlidhjes mes disa bashkive të tilla si Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Lezhë dhe asaj ndërkufitare me bregdetin e Malit të Zi, liqenin e Shkodrës dhe në aksin e dy kryeqyteteve Tiranë dhe Podgoricë, Shkodra luan dhe do të vijojë të ketë një rol kyç në dinamikat e zhvillimit arsimor, social dhe kulturor për të gjithë rajonin dhe komunitetin e Veriut, madje shtrirë dhe përtej kufirit.

Pas viteve '90 u ndërmorën një sërë reformash dhe u miratuan një sërë ligjesh të cilat e ndrruan kryekëput mënyrën e qeverisjes dhe sollën ndryshim drastik në jetën ekonomiko- sociale të vendit. Ekonomia ndryshoi nga e centralizuar dhe e planifikuar në një ekonomi të tregut të lirë. Si rezultat i këtyre reformave, ndryshime të mëdha ndodhën në strukturën ekonomike të Bashkisë Shkodër.

Shkodra dhe rajoni i Veriut me të gjithë tërësinë e vlerave dhe burimeve natyrore dhe ekonomike, kontribuon në mënyre thelbësore, direkt dhe indirekt në vlerat e përgjithshme ekonomike dhe sociale kombëtare, si në ekonomi, tregëti, bujqësi, në promovimin e imazhit ndërkombëtar të vlerave me të mira natyrore, kulturore dhe atyre shpirtërore. Shkodra me resurset dhe vlerat e saj kontribuon në PBB kombëtare nepërmjet sistemit hidrik në prodhimin e energjisë elektrike, në prodhimin mineral, si dhe kontributin e saj nga të ardhurat doganore dhe tatimore etj.

4. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Shkodër janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disponueshme mbi praktikën e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdoren për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmblyëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

5. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Komunikimi i vazhdueshëm në institucionet publike është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut. Institucione të ndryshme përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun qoftë në funksion të promovimit të aktiviteteve të tyre apo në funksion të përmbushjes për të drejtën për informim.

Ndër elementët kryesorë për të mbajtur një publik të informuar janë edhe mediat e ndryshme të cilat ndiqen nga qytetarët. Përdorimi i teknologjive të reja dhe mediave sociale ka shtuar ndjeshëm nivelin e komunikimit midis institucioneve dhe publikut, aktorëve politikë e publikë me publikun dhe anasjelltas.

Stukturat kryesore në bashkinë Shkodër të cilat merren me përpunimin e informacionit dhe komunikimin me qytetarët lëvizin kryesisht nëpërmjet Zyrës me një Ndalesë, Zyrës së Medias dhe Zyrës së Teknologjisë

- **Zyra me një Ndalesë** është kontakti i parë me qytetarët sapo futesh në bashki. Në këtë zyrë punonjësit merren me problematikat dhe çështjet e qytetarëve duke i drejtuar ato në strukturat përkatëse për zgjidhje. Shërbimet e zyrës me një ndalesë lehtësojnë marrëdhënien e qytetarëve dhe bizneseve për një sërë grup shërbimesh administrative si: vërtetime, kërkesa, ankesa, aplikime për leje dhe autorizime të ndryshme, marrje informacioni etj. Zyra me një ndalesë quhet ndryshe edhe zyra e informacionit, ku bëhen kërkesa apo shkresa për informim.
- **Zyra e Shtypit** merret me pasqyrimet e takimeve të kryetarit të bashkisë dhe aktiviteteve të ndryshme që organizon bashkia. Zyra e medias organizon konferenca për shtyp ose deklarata, gjithashtu administron rrjetet sociale të bashkisë dhe shpërndan informacionin në mediat lokale. Detyra e tyre është t'u përgjigjen në kohë kërkesave të mediave dhe përdoruesve në përgjithësi.
- **Zyra e Teknologjisë** merret më shumë me pjesën teknike të publikimit të informacionit. Në këtë zyrë informacioni shkon i gatshëm nga sektor të ndryshëm dhe ato bëjnë përditësimet e nevojshme kryesisht në faqen Eëb të Bashkisë. Formatin në të cilin ato publikojnë informacionet është i gatshëm dhe mundohen që publikimet t'i përshtaten atij formati duke dhënë një pamje të rregullt dhe estetike për syrin.


Në kohët që jetojmë mediat sociale janë bërë një nga mënyrat më të rëndësishme të informimit. Bashkia Shkodër mediat sociale i shikon si një mënyrë komunikimi për një audiencë të caktuar. Duke qenë se këto media përdoren më shumë nga moshat e reja audiencia e synuar në këto komunikime është ky target grup i caktuar.

Mediat sociale në Bashkinë Shkodër menaxhohen nga punonjësit e zyrës së shtypit. Kjo platformë komunikimi shikohet si një dritare ku mund të krijohet njëfarë “pavarësie”, sepse mesazhin e formojnë vetë punonjësit dhe e postojnë të plotë pa censurë. Pra, nga vetëadministrimi i këtyre mediave informacioni shkon i plotë tek ndjekësit dhe japin mesazhin që ato duan të përcjellin.

Komunikimet e ndërhuara në mediat sociale e kanë kapërcyer me kohë “detyrimin e informimit të publikut”. Sot bëhet falë për **ndërveprim**, gjë e cila nuk është e shkruar në asnjë ligj. Për këtë arsye, ndërtimi i komunikimeve vetëm për të përmbushur detyrimin ligjor, nuk është as konform ligjit dhe as konform rregullave të komunikimeve të reja.

Faqja Web e Bashkisë Shkodër

Bashkia e Shkodrës, si shumë institucione të tjera zotëron një faqe në Web me prapashtesën gov.al. Kjo faqe në web është e ndërtuar më shumë mbi bazën e dhënies së informacionit në formën e shkruar dhe shikohet si një nga mënyrat e cila bashkia komunikon me qytetarët. Pamja e parë që shfaqet sapo hapim faqen janë disa foto të qytetit dhe një menu ku mund të klikojmë për të marrë informacione të ndryshme për: bashkinë, këshillin bashkiak, programin e transparencës, shpallje apo njoftime, informacione rreth Shkodrës, për biznesin, për qytetarët, etj.



Rrjeti Social Facebook



Faqja zyrtare në Facebook e Bashkisë menaxhohet nga punonjësit e Zyrës së medias në këtë bashki. Bashkia Shkodër në këtë faqe ka rreth 23 mijë ndjekës, të cilën e përdor si një platform tjetër komunikimi dhe informimi për qytetarët.

Nga monitorimi që është bërë postimet në këtë faqe janë pothuajse 2-3 në ditë në varësi të aktiviteteve. Postimet janë të përbëra nga foto dhe tekst të cilat tregojnë aktivitetet të ndryshme të bashkisë, përfundimin e projekteve të ndryshme, takime ose mbledhje si dhe promovimin e pikave të ndryshme turistike.

Buletini Informativ Elektronik

Si një mënyrë tjetër e komunikimit me qytetarët bashkia Shkodër që para dy vitesh ka prezantuar “Buletinin Informativ Elektronik”. Ky buletin shikohet nga Bashkia Shkodër si një tjetër urë komunikimi dhe transparence me banorët e qytetit. Buletini Informativ Elektronik vjen në mënyrë online për të gjithë ato qytetarë që duan të njihen me atë çfarë ndodh në territor. Buletini publikohet një herë në muaj ku përmbledhen informacione dhe lajme që shpërndahen përgjatë një muaji në media të ndryshme. Buletini përgatitet nga Zyra e Shtypit dhe shpërndahet në mediat sociale të Bashkisë.



Mjetet e Informimit

Me hyrjen në fuqi të Reformës së re Administrativo - Territoriale, Ligji nr.115/2014 për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë ofrimi i shërbimeve për qytetarët në njësitë administrative, kërkon zbatimin e një sistemi informatik, i cili zbaton procedurat e miratuara paraprakisht nga Bashkia (rregulloren e shërbimeve administrative dhe manualin përkatës). Bashkia Shkodër, me njësitë e saj administrative ofrojnë shërbime sipas modelit të zyrave me një ndalesë duke garantuar kosto të ulët shërbimi dhe kohë më të shkurtuar, duke rritur transparencën dhe cilësinë e shërbimeve të saj.

Komunikimet e Drejtpërdrejta

Komunikimi i drejtpërdrejtë ose ndryshe ballë për ballë është një nga mënyrat më të përdorura por ndoshta edhe më të besueshme në transmetimin e mesazhit. Mënyra më e besueshme e komunikimit sepse në këtë mënyrë aktorët e komunikimit kuptojnë më mirë reagimin që marrin nga njëri-tjetri. Ky lloj komunikimi është edhe një nga mënyrat që Bashkia Shkodër ka zgjedhur të komunikojë me qytetarët e saj. Komunikimin ballë për ballë Bashkia Shkodër e realizon përmes dëgjësave publike të cilat zhvillohen në institucion në ditë të caktuara, për çdo problematik apo çështje që kanë qytetarët.

6. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË SHKODËR

Anketimi me përfaqësues të Bashkisë Shkodër përfshiu 8 nëpunës të këtij institucioni. Të intervistuarit janë punonjës të drejtorive dhe sektorëve të ndryshëm të Bashkisë Shkodër të cilët punojnë dhe/kanë kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.



Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore

Në zbatim të detyrimeve të parashikuar në Ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” në Bashkinë Shkodër të anketuarit janë pyetur mbi rëndësinë e njoftimit në vendimmarrjen vendore. Siç vërehet edhe nga përgjigjet, rëndësia e këtij komponenti domethënës të mirëqeverisjes në nivel vendor për të gjithë punonjësitë e bashkisë vlerësohet si një proces shumë i rëndësishëm.

E drejta për informim është e garantuar në përputhje me Ligjin 119/2014, ku secili ka të drejtën dhe mund të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore dhe insitucionet publike duhet të garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit për të gjithë. Shumë të rëndësishëm e cilësojnë këtë proces për qytetarët të gjithë të intervistuarit e Bashkisë Shkodër.



Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin publik”, si dhe Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, mbështesin dhe nxisin procese gjithëpërfshirëse të konsultimit me komunitetin. Punonjësit e Bashkisë së Shkodrës në masën 100% e vlerësojnë si një proces *shumë të rëndësishëm* konsultimin me publikun. Po ashtu nga monitorimi i bërë duket se Bashkia Shkodër e ka realizuar këtë

proces.



për njohjen që kanë për kuadrin ligjor që lidhet me njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor. Përgjigjet tregojnë që 87.5% e të intervistuarve e njohin **shumë mirë** atë, ndërsa 12.5% **mirë**. Ky është një rezultat pozitiv, por më tepër duhet bërë në drejtim të njohjes dhe zotërimit të plotë të bazës ligjore në funksion të punës së tyre me qytetarët.

Kuadri Ligjor për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin në Nivel Vendor

Është e rëndësishme që punonjësit e pushtetit vendor të jenë të pajisur me njohuritë e duhura dhe në përputhje me detyrimin ligjor për ushtrimin efektiv të funksionit të tyre publik.

Për këtë arsye të intervistuarit u pyetën




Që ligjet të jenë efektive dhe të mirëzbatueshme, ato duhet të gëzojnë jo vetëm njohjen dhe kuptueshmërinë e profesionistëve të cilët i përdorin ato në punën e përditshme. Qytetarët shpesh ankohen për zbatimin e mirë dhe të barabartë të ligjit, ndërsa punonjësit e

administratëts për nevojë për përmirësim dhe plotësim të tij.

Të pyetur për vlerësimin e kuadrit ligjor që lidhet me me njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore të intervistuarve nga Bashkia e Shkodrës janë shprehur si më poshtë:

- 62.5% e është i qartë, por jo i plotë,
- 25% është i paqartë por i plotë
- 12.5% i qartë dhe i plotë.
-



Koordinatori për Konsultimin Publik dhe Transparencën


Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik, parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", ligji nr.

139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, "Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike.



Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm dhe detyra të përcaktuara qartë në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike. Të intervistuarit në bashki janë përgjigjur në masën 100% për ekzistencën e koordinatorit për konsultim publik dhe për transparencën. Të dhënat e koordinatorit duhet të afishohen publikisht, në faqen zyrtare të bashkisë. Nga monitorimet e kryera në faqen zyrtare web të Bashkisë Shkodër janë të publikuara të dhënat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Instrumentat për Njoftimin e Qytetarëve



Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Shkodër duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Vërehet se format më të përdorura janë lajmërimet e afishuara në ambientet e bashkisë, si dhe në mediat sociale dhe ato audio-vizive.

Sipas të intervistuarve lajmërimet individuale nëpërmjet postës dhe postës elektronike kryhen për çështje apo njoftime specifike për persona të caktuar dhe përdoren në raste të caktuara.

Ndarja e informacionit me qytetarët realizohen si më poshtë;

- njoftime publike të afishuara në ambientet e bashkisë (100%)
- njoftime në mediat audiovizive (100%)
- njoftime në mediat sociale (100%)
- njoftime individuale nëpërmjet postës (87.5%)
- njoftime individuale nëpërmjet postës elektronike (38%)

Regjistri Elektronik

Mbajtja dhe publikimi i regjistrit elektronik është një detyrim ligjor që duhet përmbushur nga çdo institucion publik, por që në praktikë nuk gjen zbatim në çdo bashki në vend. Duket që ky nuk është rasti i Bashkisë Shkodër dhe kjo është një praktikë e mirë, e cila duhet të vlejë si shembull i mirë për t'u përdorur dhe vënë në zbatim.

Nga monitorimet në faqen web të Bashkisë regjistri elektronik është i publikuar dhe ndahet në:

- regjistri për ankesa, kërkesa dhe vërejtje
- regjistri i projekt-akteve për konsultim publik të këshillit bashkiak

- regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të këshillit
- regjistri i peticioneve dhe iniciativave qytetare

Nga anketimi me stafin e Bashkisë Shkodër rezulton që rreth 75% e tyre janë në dijeni të ekzistencës së regjistrimit elektronik dhe po aq edhe të publikimit të tij online. Po ashtu, nga vëzhgimet e kryera ky regjistër përditësohet nga zyra e teknologjisë pasi informacioni i shkon nga departamentet përkatëse.



Instrumentat e Informimit

Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Shkodër për informimin e qytetarëve, vihet re rëndësia e Zyrave me Një Ndalesë, faqja zyrtare e bashkisë si dhe mediat sociale pasi 100% e të intervistuarve i shohin si mjete të rëndësishme për informimin e qytetarëve. Më pas si format më të përdorura për informimin e qytetarëve 87.5% janë votuar këndet e informimit në ambientet e bashkisë si dhe 75% botimet e bashkisë.

Në zgjedhjet e tyre është edhe regjistri elektronik (50%) si detyrim ligjor për publikimin e informacioneve që lidhen me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik. Po ashtu është edhe bashkëpunimi me mediat lokale me synimin e ndarjes së informacionit duke i parë ato si një nga platformat më të ndjekura nga qytetarët. Ndërsa, prodhimi dhe përdorimi i materialeve informuese të tilla si fletëpalosjet, etj, (25%) është ndër format më pak të përdorura për informimin e qytetarëve.



Të anketuarit janë pyetur për sfidat dhe vështirësitë që ndeshin në njoftimin dhe informimin e publikut, ato kanë shprehur se komunikimi me qytetarët duhet të jetë gjithmonë i thjeshtë, i strukturuar dhe i kuptueshëm. Njoftimi realizohet i plotë në forma të ndryshme të komunikimit, por një aleat i rëndësishëm janë edhe administratorët në njësitë administrative të cilët përçojnë mesazhin tek komuniteti.

Aksesi i qytetarëve në dokumenta



Të pyetur për aksesin që kanë qytetarët për të marrë dokumenta apo informacione të ndryshme në masën 100% punojësit e institucionit janë përgjigjur se në Bashkinë Shkodër informacioni për qytetarët është lehtësisht i aksesueshëm.

Tek Zyra me një Ndalesë gjendet koordinatorja për të drejtën për informim, e cila i mundëson qytetarëve njohjen me

informacionin publik brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara me ligj. Institucioni po ashtu e ka për detyrë të prodhojë dhe të publikojë informacion, i cili është i thjeshtë dhe i kuptueshëm për qytetarin.

Informacionet të cilat kërkohen nga Bashkia Shkodër ofrohen pa pagesë me përjashtim të rasteve kur me ligj apo VKB është përcaktuar tarifë për një shërbim të caktuar. Po ashtu, informacioni i kërkuar me rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë. Nga monitorimet e kryera në faqen web, në foton më poshtë paraqitet regjistri i ankesave dhe kërkesave i përditësuar, tregues mjaft i mirë i përmbushjes së këtij shërbimi.

**Programi i
Transparencës**

► Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë

► Transparenca dhe Logaridhënia Ekonomiko-Financiare

► **Për kërkesat për informim**

► Standardet dhe procedurat e kërkesës

► **Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve**

► Informacioni i dhënë më parë

► Trajtimi i kërkesave për informacion

► Kufizimi i së drejtës për informim

► Tarifa për dhënien e informacionit

► Informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh

► Mbi shërbimet që ofron bashkia

Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve 2022

Nr.	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Statusi i kërkesës	Tarifa
01	19.01.2022 Nr.926 protokolli	Cilat janë zonat apo rrugët ku ka korsi të dedikuara biçikletash në qytetin e Shkodrës? A ka në plan Bashkia e Shkodrës në 5 vitet e ardhshme të shtojë në zona dhe rrugë të caktuara korsi biçikletash të reja? A ka Bashkia e Shkodrës statistika se sa përdorues biçikletash ka në qytetin e Shkodrës?	03.02.2022 Nr.926/1 protokolli Email Përgjigje	Përfunduar	Nuk ka
02	22.02.2022 Nr.2867 Prot Email	Sa kohë ka zyra e projektit "Bashkitë për në Europë" që është hapur në bashkinë Shkodër? Kush është personi/at që drejton zyrën e projektit "Bashkitë për në Europë" të financuara nga BE-ja? Një cv me të dhëna ose një informacion në lidhje me arsimimin e personit/personave që drejtojnë këtë zyrë. Kush e ka emëruar këtë person në krye të kësaj detyre? Me çfarë merret konkretisht kjo zyrë? Cili është roli i saj në lidhje me progresin që bën bashkia dhe për integrimin evropian? Si organizohet dhe koordinohen punët në një ditë normale brenda në zyrë? Si organizohet puna kur ka një projekt ose veprimtari të tjera? Si bini në kontakt me të ardhurat për financimin e këtyre projekteve? A merrni buxhetin e plotë 100% nga financimi që ju bën BE apo një pjesë e mban bashkia? Çfarë rezultatesh dhe punësh keni arritur deri tani që të kryeni?	04.03.2022 Nr.2867/1 protokolli Email Përgjigje	Përfunduar	Nuk ka
03	28.03.2022 Nr.4790	A janë në funksionim Impiantet e Trajtit të Ujërave të Ndotura në Bashkinë e Matitit?	11.04.2022 Nr.4790	Përfunduar	Nuk ka

Publikimi i akteve në faqen zyrtare

Nga një vëzhgim i faqes zyrtare web të Bashkisë në menunë Regjistri i Akteve janë të publikuara të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak. Të intervistuarit pohojnë në masën 100% se realizohet publikimi i akteve në faqen zyrtare, si dhe afishimi i tyre në vende të caktuara për çështje të ndryshme (shih tabelat më poshtë).




Hartimi i Programit të Transparencës

Ligji 119/2014 detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar Programin e Transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Program Transparence quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë. Programi i Transparencës publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar

“Programi i Transparencës” në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.

Të intervistuarit u shprehën në masën 100% se bashkia harton dhe publikon programin e transparencës si dhe raportet vjetore për transparencën. Nga monitorimi i kryer, programi i transparencës si dhe hartimi dhe publikimi i raporteve vjetore për transparencën në vendimmarrje janë të publikuara në faqen zyrtare dhe mund të aksesohen lehtësisht <https://bit.ly/3NsVQNF>.



Anketuesit pohojnë se programi i transparencës përfshin numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjat vitit, numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numrin e rekomandimeve të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes si dhe numrin e takimeve publike të organizuara. Bashkia Shkodër publikon gjatë çdo katër mujori, raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit ku mund të gjenden lehtësisht në faqen e bashkisë siç paraqitet më poshtë.

Rreth Shkodrës | Vizitori | Për Biznesin | Për Qytetarët | Kërko

Kërko

Share Print Email

Raportime

RAPORTIM I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT 4-MUJORI VITI 2022

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit 4- mujori viti 2022.

Aneksat e monitorimit 4- mujori viti 2022.

Matrica e realizimit të 4- mujori viti 2022.

RAPORTIM I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT VITI 2021

Projekt - Vendimi " Për miratimin e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2021 të Bashkisë Shkodër.

Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit viti 2021.

Bashkia Shkodër sa i përket njoftimeve për konsultimet publike ka të publikuara në faqen web “Planin vjetor për procesin e vendimmarrjes për vitin 2022” duke rritur kështu transparencën dhe pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes. Po ashtu, praktika e publikimit të proces verbaleve të takimeve për konsultime publike është një shembull i mirë.

Share  Print  | Email 

Plani vjetor për procesin e vendimmarrjes me pjesmarrje për vitin 2022

Nr.	Data e Njoftimit	Tematika e Dëgjesës Publike	Vendi i dëgjesës	Data e dëgjesës	Ora
1	Qershor	Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 për Bashkinë Shkodër	Salla e këshillit Bashkiak	Qershor 2022	
2	Tetor	Në kuadër të përgatitjes së Buxhetit të vitit 2023 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 përfundimtar	Salla e këshillit Bashkiak	Tetor 2022	
3	Dhjetor	Draft Buxheti i vitit 2023 dhe plani buxhetor afatmesëm 2023-2025 i Bashkisë Shkodër	Nj.A , Lagje	Dhjetor 2022	

Trajnimet mbi Detyrimet Ligjore mbi Informimin Publik



Të pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut, rreth 87.5% e të intervistuarve janë përgjigjur se kanë zhvilluar trajnime të tilla dhe 12.5% nuk kanë marrë trajnime. Po ashtu, ato janë shprehur se ka gjithmonë nevojë për të tilla trajnim në organizimin e tryezave të diskutimit duke ndarë eksperiencat apo praktikat e mira apo për të bërë propozime konkrete për përmirësimin e akteve nënligjore.

7. GJETJET NGA AKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E KËSHILLIT BASHKIAK

Anketimi me Këshillin Bashkiak Shkodër përfshiu Kryetaren e Këshillit Bashkiak, Sekretarin e Këshillit si dhe 2 anëtarë të komisioneve të ndryshme. Të intervistuarit përfaqësojnë komisione apo pozicione të caktuara të cilat kanë të bëjnë me procese që lidhen me të drejtën e informimit, njoftimin, dhe konsultimin publik me qytetarët.

Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që përdor institucioni i Bashkisë, përfshirë Këshilli Bashkiak Shkodër për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore

Të intervistuarit e Këshillit Bashkiak Shkodër e vlerësojnë në masën 100% rëndësinë e njoftimit dhe informimit në vendimmarrjen vendore. Sipas tyre, njoftimi i publikut për mbledhjet e Këshillit realizohet në forma të ndryshme duke e shikuar si një element shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e qytetarëve në procese të ndryshme konsultuese.




Pjesëmarrja qytetare është një e drejtë e qytetarëve në kuadër të qeverisjes, prandaj

për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të ketë pjesëmarrje. Kështu që të intervistuarit e kanë vlerësuar në masën 100% si shumë të rëndësishëm konsultimin me ta. Sipas këshilltarëve, mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë një proces shumë i rëndësishëm për sa i përket konsultimit publik në vendimmarrjen vendore.

Baza Ligjore për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin

Këshilli Bashkiak ushtron të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e tij në kuadër të misionit të vetëqeverisjes dhe autonomisë vendore dhe siguron qeverisjen e efektshme, efikase në një nivel sa më afër qytetarëve.

Ndërkohë që Bashkia është trupa ekzekutive dhe Këshilli Bashkiak është ajo legjislative, është e thelbësore njohja e thellë e kuadrit ligjor nga ana e atyre që marrin vendimet më të rëndësishme për jetën e qytetarëve, pra këshilltarëve. Për këtë arsye, u pyetën këshilltarët për njohuritë e tyre mbi bazën ligjore përkatëse dhe vlerësimin e tyre për të.



Të gjithë të këshilltarët e përfshirë në anketim janë shprehur se e njohin shumë mirë bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore. Rreth 75% e anëtarëve të Këshillit Bashkiak e vlerësojnë kuadrin ligjor si të qartë dhe të plotë, ndërsa rreth 25% e vlerësojnë si të qartë por jo të plotë.

Rregulloret e Këshillit Bashkiak

Gjatë viteve të shkuara të mbështetur edhe nga Projekti “Bashki të Forta” çdo këshill bashkiak në vend ka zhvilluar dhe miratuar disa rregullore, të tilla si rregullorja e përgjithshme e këshillit bashkiak, rregullorja për marrëdhëniet me publikun dhe median,

rregullorja për etikën dhe rregullorja e kërkesë-ankesave. Këto instrumenta synojnë të rregullojnë dhe lehtësojnë procese dhe funksione të caktuara të këshillit bashkiak.



Të gjithë pjesëmarrësit në anketim i vlerësojnë rregulloret e Këshillit Bashkiak si të qarta dhe të plota.

Vërehet mungesa nga ana e Këshillit Bashkiak të një rregulloreje të mirëfilltë për realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit. Në lidhje me këtë proces ekzistojnë disa rregulla të

shpërndara, dhe aktualisht janë në proces të miratimit të një rregulloreje të mirëfilltë.

Gjithashtu, të pyetur nëse do të kishte nevojë për rishikime apo plotësime cilat do të ishin rekomandimet e tyre, këshilltarët u shprehën se rregullorja e konsultimit me publikun mund të përshtatet në varësi të nevojave, kërkesave të institucionit dhe qytetarëve konform konturit ligjor.

Bashkëpunimi mes Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak



Të intervistuarit janë përgjigjur në masën 100% pozitiv dhe vlerësues sa i përket bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Shkodër për procesin e njoftimit dhe informimit me publikun.

Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet formave të ndryshme të komunikimit duke nisur me ato formale nëpërmjet e-mail, kërkesave për informim, tryeza diskutimi apo shpërndarje e

informacioneve në mediat sociale për informim të qytetarëve.

Shembulli më i mirë që ato japin janë zhvillimi i përbashkët i dëgjesave publike që janë realizuar në kuadër të hartimit të buxhetit 2022 si dhe PBA 2022-2024.

Në foton më poshtë, paraqitet njoftimi i cili është publikuar në rrjetin social Facebook në faqen e Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Shkodër. Në këtë postim është paraqitur

kalendari i dëgjësive publike me datat dhe oraret dhe vendet e caktuara, duke informuar kështu qytetarët për tu bërë pjesë e këtyre mbledhjeve.



Këshilli Bashkiak Shkodër

11 tetor 2021 · 🌐

Të nderuar qytetarë,

Në kuadër të hartimit të Buxhetit 2022 dhe PBA 2022-2024, mbështetur në nenet 18 dhe 54 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Këshilli Bashkiak Shkodër ju njofton kalendarin dëgjësive publike.

Dëgjësat do të zhvillohen në të gjitha Njësitë Administrative dhe Lagjet nr. **1**, **2**, **3**, **4** dhe **5** të Bashkisë Shkodër... Shiko më shumë

Nr	Titulli	Data	Orari	Orari	Muajt	Forma
1	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Lezhës dhe Malit	15.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online
2	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Durrësit	18.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online
3	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Vlorës	18.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online
4	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Shkupit	20.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online
5	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Prizrit	21.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online
6	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Prishtinës, Pezës, Shkupit dhe Strugës	19.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online
7	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Prizrit	25.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online
8	Konsultim publik me bashkitë e rrethit administrative të Prizrit	26.10.2021	19:00	21:00	Tëri i ditës	Online

Publikimi i Njoftimeve për Mbledhjet e Këshilli Bashkiak

Nga monitorimet e kryera vihet re se Këshilli Bashkiak Shkodër njofton për mbledhjet e këshillit 5 ditë para zhvillimit të mbledhjes dhe informacioni publikohet në rrjetin social Facebook. Njoftimi për mbledhjen e Këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Të intervistuarit po ashtu kanë pohuar se ky rregull zbatohet plotësisht.



Nga monitorimi që kemi kryer në faqen zyrtare të Këshillit Bashkiak, të gjitha mbledhjet e këshillit njoftohen 5 ditë përpara zhvillimit të tyre duke vendosur datën, orën dhe vendin e caktuar. Në foton më poshtë mund të vini re se përveç detajeve të mbledhjes paraqiten edhe projektvendimet të cilat janë pjesë e rendit të ditës.

Këshilli Bashkiak Shkodër
25 mars · 🌐

NJOFTIM

Për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Të nderuar qytetarë,

Këshilli Bashkiak Shkodër njofton thirrjen e mbledhjes së tij të radhës ditën e ENJTE, datë 31.03.2022, ora 16:00.
Mbledhja do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit bashkiak.

Duke ju falenderuar,

KRYETARE
Brisela KADIJA

dati të Kryetarit të Bashkisë Shkodër, për zgjedhjet e pjesulme për organet e qeverise të datës 6.3.2022, sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër n 20.3.2022

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Shkodër, më 25.3.2022

NJOFTIM
Për thirrjen e mbledhjes së këshillit bashkiak

Duke ju falenderuar,

KRYETAR

BRISELA KADIJA

Komisione	Dita	Data	€
Komisioni për çështjet ligjore	E marte	29.3.2022	1
Komisioni i bashkët	E marte	29.3.2022	1
Komisioni për çështje sociale	E marte	29.3.2022	1

P/ Vendim: "Për përcaktimin e fondit aksesi në fondin e kushtetuar për ndihmë"

Publikimi i Akteve të Këshillit Bashkiak

Neni 18 i Ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë Ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: "Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim".



Nga monitorimet e kryera në faqen web të bashkisë Shkodër janë të publikuara të gjitha

Vendimet e Këshillit Bashkiak. Po ashtu, të gjithë të anketuarit e kanë pohuar këtë, ndërsa për publikimin e akteve në vende me akses të lirë publik kanë votuar në masën 50%, duke qenë se mund të publikohen vetëm akte të caktuara.

Sapo hapim faqen web të Bashkisë Shkodër na shfaqen të gjitha projektvendimet e mirtuara së fundmi por gjithashtu mund të këqojmë edhe për projektvendimet më të hershme.

- i** **Vendim i Këshillit Bashkiak** Nr.: 25 Dt.: 10.05.2022
PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA PRANË QENDRËS KOMUNITARE PËR FAMILJEN NR. 6 DHE BANESAT SOCIALE ME QIRA PËR KOMUNITETIN ROM PËR VITIN 2022
[\[Shkarko Aktin \]](#) [\[Shto koment \]](#)
- i** **Vendim i Këshillit Bashkiak** Nr.: 24 Dt.: 10.05.2022
PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE PRANË BANESAVE SOCIALE ME QIRA TEK ISH KONVIKTI I SHKOLLËS VETERINARE DHE TË RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E BANESAVE SOCIALE ME QIRA TË BASHKISË SHKODËR
[\[Shkarko Aktin \]](#) [\[Shto koment \]](#)
- i** **Vendim i Këshillit Bashkiak** Nr.: 23 Dt.: 10.05.2022
PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA PRANË ISH-KONVIKTI TË SHKOLLËS VETERINARE TË BASHKISË SHKODËR.
[\[Shkarko Aktin \]](#) [\[Shto koment \]](#)
- i** **Vendim i Këshillit Bashkiak** Nr.: 22 Dt.: 10.05.2022
PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËS LEKAJ NË RRUGA MIRASH ZEF PREKA NJËSIA ADMINISTRATIVE SHALË
[\[Shkarko Aktin \]](#) [\[Shto koment \]](#)
- i** **Vendim i Këshillit Bashkiak** Nr.: 21 Dt.: 10.05.2022
PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË NJË SEGMENTI TË RRUGËS JUSTIN GODART NË RRUGA GJOSHO VASIJA NË BASHKINË SHKODËR
[\[Shkarko Aktin \]](#) [\[Shto koment \]](#)
- i** **Vendim i Këshillit Bashkiak** Nr.: 20 Dt.: 10.05.2022
PËR NDRYSHIMIN E EMËRTIMIT TË NJË SEGMENTI TË RRUGËS HALLUNAJ NË RRUGA TENISIT NJËSIA ADMINISTRATIVE RRETHINA
[\[Shkarko Aktin \]](#) [\[Shto koment \]](#)
- i** **Vendim i Këshillit Bashkiak** Nr.: 19 Dt.: 10.05.2022
PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË BASHKISË SHKODËR DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË

Njoftimi dhe Informimi i Publikut

Pavarësisht se të intervistuarit e përfshirë në anketim janë shprehur se Këshilli Bashkiak Shkodër i ka të gjitha burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit për publikun, praktikisht kjo nuk është e mundur. Për ta realizuar në të gjithë dinamikat e veta ashtu siç edhe parashikohet në ligj, këto procese kërkojnë burime




financiare dhe njerëzore të paracaktuara dhe në dispozicion të Këshillit, e cila momentalisht nuk ndodh në asnjë bashki në vend.

Sipas të intervistuarve Këshilli Bashkiak i Shkodrës e realizon njoftimin dhe informimin e publikut përmes formave të


ndryshme të komunikimit duke përfshirë këtu mediat sociale apo takimet e drejtëpërdrejta me qytetarët.

Regjistri Elektronik




Këshiltarët janë pyetur gjithashtu për regjistrin elektronik, ku të gjithë janë përgjigjur se janë në dijeni të publikimit të tij në faqen web të Bashkisë Shkodër. Kjo është një gjetje pozitive, e cila mund të lidhet me ekzistencën e tre regjistrave që kanë të bëjnë me punën e Këshillit, të tilla si: regjistri i projekt-akteve për konsultim publik të këshillit bashkiak; regjistri publik për transparencën e

mbledhjeve të këshillit dhe regjistri i peticioneve dhe iniciativave qytetare.



REGJISTËR ELEKTRONIK

ANKESA, KËRKESA, VËREJTJA, PETICIONI DHE INICIATIVA JUAJ ME NJË KLIK



Bashkia Shkodër

REGJISTRI I ANKESAVE, KËRKESAVE DHE VËREJTJEVE

REGJISTRI I PROJEKT AKTEVE PER KONSULTIM PUBLIK, TE KESHILLIT BASHKIAK

REGJISTRI PUBLIK PER TRANSPARENÇEN E MBLLEDHJEVE TË KESHILLIT

REGJISTRI I BRENDSHËM I PETICIONEVE DHE INICIATIVAVE QYTETARE

REGJISTRI I ANKESAVE, KËRKESAVE DHE VËREJTJEVE												
Nr.	Kërkesë	Ankesë	Vërejtje	Kodi i regjistrimit	Çështja	Data e Regjistrimit në Protokollin e Bashkisë	"Organi/drejtorja/ sektori që i është dërguar ankesa/ kërkesa (Nr. prot të brendshëm)"	"Dërgimi për mendim në Komisionin përkatës të Këshillit (Nr. prot të brendshëm)"	Kaluar në Këshill për shqyrtim (data)	"Mbështetur nga Këshilli (kërkesa, ankesa) Po/Jo"	"Zbatuar nga Ekzekutivi (Data)"	"Përgjigja (data dhe numri)"
1	Po				Emertim rruge	Nr.2250 dt:11/02/2022	Dërguar Kryetares së Bashkisë Nr.2425 dt:15/02/2022	15/02/2022				

Programi i Transparencës



Publikimi dhe përditësimi i Programit të Transparencës në faqen zyrtare të ëeb të Bashkisë përbën një detyrim ligjor për organet publike që rrjedh nga Ligji 119/2014.

Programi i Transparencës përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të ofrohet nga bashkia pa kërkesë.

Këshilltarët e intervistuar u shprehën në masën 100% se janë në dijeni të Programit të publikuar të Transparencës në faqen web të Bashkisë.

Publikimi i Raporteve Vjetore të Transparencës



Po ashtu, janë pyetur në lidhje me publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes dhe 75% e tyre kanë thënë se Këshilli Bashkiak nuk publikon raporte të tilla.

Programet e transparencës ndërtohen dhe publikohen vetëm nga Bashkia Shkodër dhe jo nga Këshilli Bashkiak.

Raportet vjetore të transparencës së bashku me Programin e Transparencës në janë të publikuara në faqen zyrtare dhe mund të aksesohen lehtësisht <https://bit.ly/3NsVQNF>.

Trajnimet në Lidhje me Detyrimet Ligjore dhe Informimin Publik

Për pyetjen a kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin publik të gjithë janë përgjigjur se kanë marrë. Por, u shprehën se gjithmonë ka nevoja për

trajtime të ndryshme, për shkëmbim eksperiencash me këshilla bashkiak në shtete të cilat kanë demokraci vendore të konsoliduar.

8. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

- ✓ Proceset e njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohet nga institucioni i Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Shkodër si procese shumë të rëndësishëm, prandaj ky shënohet si një hap pozitiv për të rritur transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje në nivel vendor.
- ✓ Strukturat kryesore në bashki të cilat ndihmojnë në informimin e publikut dhe mbajnë e zhvillojnë marrëdhënien me publikun dhe mediat janë “Zyra me një Ndalesë” dhe “Zyra e Medias”. Pavarësisht mënyrës së funksionimit të marrëdhënieve me publikun në institucion, mund të vlerësohet pozitivisht funksionimi i zyrave të pritjes dhe shërbimit të qytetarëve, si dhe procesit të kërkesë-ankesë në përputhje konfort me ligin.
- ✓ Bashkia Shkodër i ndërton komunikimet publike me qytetarët nëpërmjet disa mënyrave si: komunikimi i drejtpërdrejtë, të cilin e zhvillon nëpërmjet takimeve në terren apo dëgjësive publike, komunikimi në mediat lokale (TV), si dhe komunikimin në mediat sociale kryesisht në Facebook.
- ✓ Pavarësisht arritjeve të deritanishme, realizimi i procesit të konsultimit publik ka ende nevojë për përmirësime. Kjo kërkon rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marr pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjësive publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.
- ✓ Bashkia duhet të përditësojë rregullisht mediat në mënyrë që ndikimi dhe informimi tek qytetarët të jetë sa më i madh. Ndërtimi i një plani strategjik komunikimi me mediat do të ndihmonte në targetimin e një grupi sa më të madh të audiencës. Ndërtimi i komunikimit të duhur në këto media siguron informimin, orientimin dhe përfshirjen demokratike të qytetarëve në qeverisjen vendore.
- ✓ Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë një nga aktivitetet më të rëndësishme në Bashki. Ato mundësojnë komunikimin me qytetarët për trajtimin e problematikave dhe çështjeve më interes për komunitetin, por për një sërë arsyesh pjesëmarrja në to është e pakët. Prandaj, shihet i nevojshëm përmirësimi i këtij aspekti, nëpërmjet konsultimit më të gjerë për marrjen e mendimit qytetarëve.

- ✓ Në përputhje edhe me Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” Bashkia Shkodër e ka ndërtuar faqen e vetë zyrtare, një strukturë e mirëfilltë për publikimin e informacioneve që lidhen me institucionin. Por nga vëzhgimi del që kjo faqe ka nevojë të përditësohet më shpesh në disa fusha.
- ✓ Duke qenë se jo të gjithë qytetarët janë të familjarizuar me përdorimin e faqes zyrtare dhe aksesin e informacionit online, nevojitet informim i vazhdueshëm i qytetarëve nëpërmjet takimeve publike.
- ✓ Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve krijon vështirësi në aksesin e informacionit apo shërbimit për shumë qytetarë, prandaj duhet të krijohet infrastruktura e nevojshme për komunikim me të gjithë banorët.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin të qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan